

Nr.01-120/107

Data: 16.12.2014

SHKUP

## POLITIKA E CILËSISË

**Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional MAPAS** është një institucion rregullator dhe mbikëqyrjeje i formuar në korrik të vitit 2002, si një subjekt juridik që mbron interesat e anëtarëve dhe anëtarëve pensionistë të fondeve pensionale, rrit nivelin e vetëdijes së opinionit lidhur me karakteristikat e sigurimit të këtij lloji dhe nxit zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional.

### **Vizioni**

Vizioni ynë nënkupton që opinionin të na dallojë si një institucion i pavarur, profesional dhe transparent, që mbron dhe avancohet sistemin pensional.

### **Misioni**

Ne kemi për mision mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe anëtarëve pensionistë të fondeve pensionale dhe inkurajimin e zhvillimit të financimit kapital të sigurimit pensional, për ditë pensioni më të sigurta.

Në punën e përditshme të punonjësve të MAPAS vjen në shprehje iniciativa dhe profesionalizimi i tyre dhe ato kujdesin shumë për efikasitetin e punës, me qëllim që të sigurohen rezultatet më të mira. Gjatë ushtrimit të aktivitetit përdoren procedura pune precize dhe plane pune të definuara paraprakisht, të shoqëruara me vlerësimin e rezultateve dhe vlerësimin e punonjësve. Në këtë mënyrë promovohet inovacioni, debati i hapur dhe ambienti i punës progresiv dhe fleksibil.

**Politika e cilësisë** është pjesë integrale e Planit strategjik të MAPAS dhe një lloj kornize e përcaktimit të qëllimeve të cilësisë.

Duke punuar për arritjen e qëllimeve, MAPAS përmbush parimet më poshtë:

- Sigurimin e infrastrukturës moderne dhe të plotë dhe shërbimeve publike efikase;
- Formimin e kulturës së re afariste dhe përcaktimin e kompetencave të personalit, me ndihmën e realizimit të programit të trajnimeve dhe motivimit të të gjithë punonjësve;

- Sigurimin e një agjencie profesionale efikase dhe efektive, me ndihmën e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe përsosjes së Sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas kërkesave të standardit ISO 9001:2008;
- Përsosjen e vazhdueshme të proceseve dhe zhvillimin e vazhdueshëm të Sistemit të menaxhimit të cilësisë;
- Sigurimin e një ambienti pune të shëndoshë dhe trajnimeve për ngritjen e nivelit të vetëdijes së punonjësve lidhur me mbrojtjen e ambientit jetësor;
- Administrimin e proceseve në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe përgjegjësi, me përkushtim dhe si një ekip;
- Mirëmbajtjen e motivacionit të punonjësve në një nivel të lartë, me ndihmën e sigurimit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
- Me politikën e cilësisë janë njohur të gjithë punonjësit dhe e njëjta është vënë në dispozicionin e opinionit.

**Politika e cilësisë është ideuar për përcaktimin dhe analizimin e qëllimeve të cilësisë. Çdo punonjës ka për detyrë të implementojë Politikën e cilësisë në kuadër të procedurave të MAPAS.**

**Shkup,**

**16.12.2014**

**Kryetari i Këshillit të ekspertëve**

**Dr.Bulent Dervishi**

**Firmë dhe vulë zyrtare e MAPAS**